qendra e provimeve

**SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT TË PROVIMIT TË MATURËS DHE PROVIMIT PROFESIONAL NGA GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA, QERSHOR 2021**

**1.** Nxënësi/nxënësja* merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: *Dallimi kryesor është, se maskat moderne kirurgjike janë bërë nga letra ose materiale të tjera të pa thura dhe duhet të hidhen pas çdo përdorimi. (dhe përgjigje të tjera të sakta)*

**2.** Është rrethuar numri *1: me tri shtresa* ***– 1 pikë***

**3.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: *N95 ose FFP.*

**4.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: *Bazuar në prova ato mbrojnë si përdoruesin, ashtu edhe personat pranë përdoruesit nga përhapja e viruseve.*

**5.** Nxënësi merr ***2 pikë*** nëse ka shënuar: *Zyrtarët kinezë e bëjnë dallimin dhe ana e kaltër e maskës duhet të vishet jashtë, me shtresën e bardhë në pjesën e brendshme.*

Nxënësi merr **1 pikë** nëse argumenton vetëm njërën përgjigje

**6.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: *Shija dhe aroma e vendit kishin lënë gjurmë në të gjithë personazhet e romanit të cilët jetonin në mërgim. (dhe përgjigje të tjera të sakta)*

**7.** Është rrethuar numri *1: jetës në mërgim* ***– 1 pikë***

**8.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: *Për të gjitha brengat, mjerimet, varfërinë që kishte lënë në vendlindjen e tij. (dhe përgjigje të tjera të sakta)*

**9.** Është rrethuar numri *4: mbrojtës* ***– 1 pikë***

**10.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: *Antikitetit (Letërsia e vjetër)*

**11.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: *elementet e tekstit letrar dhe joletrar*

**12.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: *Përdorimi i shkronjave të mëdha tregon thelbin e asaj çka gjendet brenda, pra poeti ndien frikë të parrëfyeshme kur sheh se çfarë shkruhet në të. (dhe përgjigje të tjera të sakta)*

---

*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

**13.** Nxënësi merr ***2 pikë*** nëse ka shkruar: *anafora dhe tercina*

Nxënësi merr *1 pikë* për përgjigje të pjesshme nëse ka shkruar saktë ose anaforën ose tercinën

**14.** Gjithsej ***3 pikë:***

A) Nxënësi merr *1 pikë* nëse ka rrethuar numrin 4: *Virgjili*

B) Nxënësi merr *2 pikë* nëse ka shkruar: *Helena, Paridi dhe Hektori janë personazhe të Iliadës, kurse Virgjili i Komedisë Hyjnore.*

Nxënësi merr *1 pikë* për argumentim të pjesshëm duke shkruar saktë vetëm njërën përgjigje.

**15.** Nxënësi merr ***2 pikë*** nëse ka shkruar: *ndryshimi i kohës* dhe argumentuar *si në hyrje të poemës dhe në mbyllje të saj lisi është fjala kryesore. Poema fillon me pranverën që simbolizon energjinë dhe forcën rinore të jetës së njeriut, ndërsa dimri tharjen dhe fundin e saj. (dhe përgjigje të tjera të sakta)*

Nxënësi merr *1 pikë* nëse ka shkruar vetëm njërën përgjigje të saktë.

**16.** Gjithsej ***2 pikë:***

A) Nxënësi merr *1 pikë* nëse ka rrethuar numrin *2: didaskalia*

B) Nxënësi merr *1 pikë* nëse ka përshkruar pjesën që i përgjigjet zgjidhjes në A: *Pemëtore e Kapuletit. Romeo dhe Zhulieta duken në dritaren e dhomës së gjumit.*

**17.** Është rrethuar numri *2: hyrje, lidhje, shtjellim, kulmim, zgjidhje;* ***– 1 pikë***

**18.** Gjithsej ***2 pikë:***

A) Nxënësi merr *1 pikë* nëse ka shkruar*: Përfitoi nga besimi i Hajrijes. ( dhe përgjigje të tjera të sakta)*

B) Nxënësi merr *1 pikë* nëse ka shkruar: *Gjinisë dramatike.*

**19.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: *S, P, P, P dhe S.*

**20.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse rishkruan fjalinë me shenjat përkatëse të pikësimit të vendosura saktë: *Kur arritën në krye të malit**[,]** dielli kishte dalë**[,]** kurse hëna dukej ende**[.]***

**21.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar për: mirë, larg – *të pandryshueshme*

*(ndajfolje)*; ky, kjo – *të ndryshueshme (përemra)*; maturant, sportist – *të ndryshueshme (emra)*

**22.** Gjithsej ***2 pikë:***

A) Nxënësi merr *1 pikë* nëse ka rrethuar numrin *3: kundrinorit të zhdrejtë me parafjalë*

B) Nxënësi merr *1 pikë* nëse ka argumentuar përgjigjen duke treguar rasën e fjalëve të nënvizuara: *rasa emërore*

**23.** Gjithsej ***2 pikë*** nëse plotëson saktë tabelën:

| Parafjalë të rasës emëror | Parafjalë të rasës kallëzore | Parafjalë të rasës rrjedhore |
|---|---|---|
| *nga, te, tek* | *në, me, për* | *prej, anë, afër* |

Nxënësi merr *1 pikë* nëse plotëson saktë dy kolona të tabelës.

**24. Skema e vlerësimit të tekstit funksional**

| **FORMA DHE PËRMBAJTJA E TEKSTIT** ***3 pikë*** | **GJUHA** ***3 pikë*** | **STILI** ***2 pikë*** |
|---|---|---|
| Të gjitha të dhënat e shkruara në udhëzim janë renditur sipas parimeve të hartimit të tekstit.<br>*3 pikë*<br><br>Të gjitha të dhënat janë renditur mirë, por mungon ndonjë e dhënë që e vështirëson kuptimin e tekstit, përkatësisht elementi kryesor që nuk e përmbys formën e tekstit.<br>*2 pikë* | Në tekst nuk ka gabime gramatikore dhe drejtshkrimore.<br>*3 pikë*<br><br>Norma drejtshkrimore dhe gramatikore pjesërisht është respektuar, por ka lëshime si:<br>- përdorimi i shenjave të pikësimit<br>- përdorimi i drejtë i pjesëve gramatikore<br>*2 pikë*<br><br>Normat gramatikore dhe drejtshkrimore janë respektuar pjesërisht: | Fjalitë janë ndërtuar qartë dhe janë në përputhje me përmbajtjen dhe formën e tekstit.<br>*2 pikë*<br><br>Në tekst ka gabime stilistike (p.sh. përsëritja e fjalëve të njëjta në një fjali ose në fjalitë që pasojnë/ drejtohet në mënyrë të gabuar/ përdorimi i pleonazmës/ mungesë e të shprehurit/ |

| | | |
|---|---|---|
| Mungojnë shumë të dhëna, por teksti kuptohet.<br>*1 pikë*<br><br>Nuk është respektuar forma e dhënë ose përmbajtja e tekstit është e pakuptueshme.<br>*0 pikë* | - nuk përdoret si duhet gjuha letrare, por e folura dialektore<br>- gabon në përdorimin e shenjave të pikësimit (p.sh. nuk përdor presjen gjatë numërimit, gjatë ndërtimit të fjalive të nënrenditura **dhe/apo**<br>- gabon në përdorimin e parafjalëve...<br>*1 pikë*<br><br>Në tekst ekzistojnë tri apo më shumë gabime thelbësore të gjuhës standarde (përdorimi i gabuar i rasave, gabime në përdorimin e shkronjës së madhe, nuk respekton rregullat e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, gabon në përdorimin e zanores *ë*, nuk zbaton rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja *j*, gabon në përdorimin e trajtës mohuese.<br>*0 pikë* | theksimi i tepruar i të dhënave.<br>*1 pikë*<br><br>Fjalitë nuk janë ndërtuar mirë, janë të paqarta, të papërfunduara...<br>*0 pikë* |

**25. Skema e vlerësimit të esesë:**

***Analiza e fragmentit nga libri i këngve "Vuajtjet e dashurisë" – Françesko Petrarka***

***Përmbajtja 7 pikë***

| | |
|---|---|
| Respektimi i kërkesave të dhëna | Hartimi i një teksti që i përshtatet kërkesave të dhëna:<br>- tregon si e ndjen veten poeti përmes këtij soneti , cili |

| | |
|---|---|
| | është shkaku i shqetësimit të tij. Nëse dashuria është ndjenjë pozitive, përse sjell vuajtje dhe pikëllim? *(1 pikë)*<br>- shkruan për figurat letrare dhe efektin e tyre duke e ilustruar me vargje *(1 pikë)*<br>- shkruaj temën, që paraqet gjendjen e mundimshme shpirtërore të poetit, si shkak i refuzimit të Laurës *(1 pikë)*<br>*Gjithsej 3 pikë* |
| Mendimi kritik, përdorimi i të dhënave, argumentimi dhe dhënia e qëndrimit personal, mendimit idesë... | Krijimi i tekstit:<br>- qasja origjinale/ kreative ndaj temës *(1 pikë)*<br>- përdorimi dhe lidhja e shembujve relevant gjatë hartimit të temës/ të dhënave në zhvillimin e temës *(1 pikë)*<br>- argumentimi i hollësishëm dhe lidhja e shembujve/ të dhënave në zhvillimin e temës *(1 pikë)*<br>- argumentimi me fakte dhe qëndrime personale *(1 pikë)*<br>*Gjithsej 4 pikë* |

***Gjuha dhe struktura e tekstit – 6 pikë***

| **GJUHA**<br>***3 pikë*** | **STILI**<br>***2 pikë*** | **FORMA GRAFIKE E TEKSTIT**<br>***1 pikë*** |
|---|---|---|
| Në tekst nuk ka gabime gramatikore dhe drejtshkrimore.<br>*3 pikë*<br><br>Norma drejtshkrimore dhe gramatikore përgjithësisht respektohet dhe është përdorur si e tillë:<br>- përdorimi i shenjave të pikësimit dhe i formulimeve gjuhësore<br>*2 pikë*<br><br>Normat gramatikore dhe drejtshkrimore janë respektuar pjesërisht: | Fjalitë janë ndërtuar qartë dhe janë në përputhje me përmbajtjen dhe formën e tekstit.<br>*2 pikë*<br><br>Në tekst ka gabime stilistike (p.sh. përsëritja e fjalëve të njëjta në një fjali ose në fjalitë që pasojnë/ drejtohet në mënyrë të gabuar/ përdorimi i pleonazmës/ mungesë e të | Përshtatja e organizimit të tekstit duke përshtatur formën e shkrimit me anën logjike (ndahen qartë hyrja, zhvillimi dhe përfundimi)<br>*2 pikë*<br><br>Mospërshtatja e formës së tekstit strukturës së tij logjike (nuk ndahen hyrja, zhvillimi dhe përfundimi).<br>*0 pikë* |

| | | |
|---|---|---|
| - nuk përdoret si duhet gjuha letrare, por e folura dialektore<br>- gabon në përdorimin e shenjave të pikësimit (p.sh. nuk përdor presjen gjatë numërimit, gjatë ndërtimit të fjalive të nënrenditura<br>**dhe/apo**<br>- gabon në përdorimin e parafjalëve...<br>*1 pikë*<br><br>Në tekst ekzistojnë tri apo më shumë gabime thelbësore të gjuhës standarde (përdorimi i gabuar i rasave, gabime në përdorimin e shkronjës së madhe, nuk respekton rregullat e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, gabon në përdorimin e zanores *ë*, nuk zbaton rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja *j*, gabon në përdorimin e trajtës mohuese.<br>*0 pikë* | shprehurit/ theksimi i tepruar i të dhënave.<br>*1 pikë*<br><br>Fjalitë nuk janë ndërtuar mirë, janë të paqarta, të papërfunduara...<br>*0 pikë* | |

**Skema e vlerësimit të esesë:**

***Mësimi në distancë gjatë pandemisë, sfidë apo përvojë?***

***Përmbajtja 7 pikë***

| | |
|---|---|
| Respektimi i kërkesave të dhëna | Hartimi i një teksti që i përshtatet kërkesave të dhëna:<br>- tregon për ndikimin e pandemisë në jetën shkollore dhe në procesin mësimorë të zhvilluar në distancë *(1 pikë)*<br>- shkruan për sfidat me të cilat janë përballë, përparësitë dhe mangësitë e mësimit në distancë, përkrahjen e mësimdhënësve dhe familjarëve *(1 pikë)*<br>- shkruan për përvojat dhe eksperiencën e fituar gjatë kësaj periudhë duke dhënë shembuj konkretë *(1 pikë)* |

| | |
|---|---|
| | *Gjithsej 3 pikë* |
| Mendimi kritik, përdorimi i të dhënave, argumentimi dhe dhënia e qëndrimit personal, mendimit idesë... | Krijimi i tekstit:<br>- qasja origjinale/ kreative ndaj temës *(1 pikë)*<br>- përdorimi dhe lidhja e shembujve relevant gjatë hartimit të temës/ të dhënave në zhvillimin e temës *(1 pikë)*<br>- argumentimi i hollësishëm dhe lidhja e shembujve/ të dhënave në zhvillimin e temës *(1 pikë)*<br>- argumentimi me fakte dhe qëndrime personale *(1 pikë)*<br>*Gjithsej 4 pikë* |

***Gjuha dhe struktura e tekstit – 6 pikë***

| **GJUHA**<br>***3 pikë*** | **STILI**<br>***2 pikë*** | **FORMA GRAFIKE E TEKSTIT**<br>***1 pikë*** |
|---|---|---|
| Në tekst nuk ka gabime gramatikore dhe drejtshkrimore.<br>*3 pikë*<br><br>Norma drejtshkrimore dhe gramatikore përgjithësisht respektohet dhe është përdorur si e tillë:<br>- përdorimi i shenjave të pikësimit dhe i formulimeve gjuhësore<br>*2 pikë*<br><br>Normat gramatikore dhe drejtshkrimore janë respektuar pjesërisht:<br>- nuk përdoret si duhet gjuha letrare, por e folura dialektore<br>- gabon në përdorimin e shenjave të pikësimit (p.sh. nuk përdor presjen gjatë numërimit, gjatë ndërtimit të fjalive të nënrenditura<br>**dhe/apo** | Fjalitë janë ndërtuar qartë dhe janë në përputhje me përmbajtjen dhe formën e tekstit.<br>*2 pikë*<br><br>Në tekst ka gabime stilistike (p.sh. përsëritja e fjalëve të njëjta në një fjali ose në fjalitë që pasojnë/ drejtohet në mënyrë të gabuar/ përdorimi i pleonazmës/ mungesë e të shprehurit/ theksimi i tepruar i të dhënave.<br>*1 pikë*<br><br>Fjalitë nuk janë ndërtuar mirë, janë të paqarta, të papërfunduara... | Përshtatja e organizimit të tekstit duke përshtatur formën e shkrimit me anën logjike (ndahen qartë hyrja, zhvillimi dhe përfundimi)<br>*2 pikë*<br><br>Mospërshtatja e formës së tekstit strukturës së tij logjike (nuk ndahen hyrja, zhvillimi dhe përfundimi).<br>*0 pikë* |

| | | |
|---|---|---|
| - gabon në përdorimin e parafjalëve...<br>*1 pikë*<br><br>Në tekst ekzistojnë tri apo më shumë gabime thelbësore të gjuhës standarde (përdorimi i gabuar i rasave, gabime në përdorimin e shkronjës së madhe, nuk respekton rregullat e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, gabon në përdorimin e zanores *ë*, nuk zbaton rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja *j*, gabon në përdorimin e trajtës mohuese.<br>*0 pikë* | *0 pikë* | |